

GREEN COAST SH.P.K.

RRUGA "TISH DAIJA", KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1., TIRANE, SHQIPËRI

L41329038D

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 11.09.2024, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **Green Coast Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 0342771384 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (këtu e në vijim referuar si "**Ortaku i Vetëm**"),

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Z. Bers Hado, këshilltar ligjor i shoqërisë, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se kapitali aktual i Shoqërisë është 5.225.815.328,00 LEK (pesë miliard e dyqind e njëzete e pesë milion e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e njezet e tetë lekë).

Në kushtet kur veprimtaria e Shoqërisë ka përformuar kënaqshëm dhe situata financiare është në përputhje me pritshmëritë, është propozuar nga ana e Ortakut të Vetëm zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë në vlerën prej 660,000 Euro (gjashtë qind e gjashtëdhjetë mijë euro), e barasvlereshme me shumën në LEK 65,742,600 (gjashtëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e dyzetë e dy mijë e gjashtë qind) sipas kursit të këmbimit 99.61 të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datë 11.09.2024

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

VENDOS:

- A. Miratimin e zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 660,000 Euro (gjashtë qind e gjashtëdhjetë mijë euro), e barasvlereshme me shumën në LEK 65,742,600 (gjashtëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e dyzetë e dy mijë e gjashtë qind) sipas kursit të këmbimit 99.61 të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datë 11.09.2024.



- B. Kapitali i Shoqërisë nga 5.225.815.328,00 LEK (pesë miliard e dyqind e njezet e pesë milion e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e njezete e tetë lekë), bëhet 5,160,072,728.00 LEK (Pesë miliard e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e dy mijë e shtate qind e njezete e tetë lekë).
- C. Të autorizojë Administratorin e shoqërisë për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), ose të autorizojë persona të tjerë përkatësisht për këto veprime.

Megenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Green Coast" sh.p.k mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.


**ASAMBLEE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
GREEN COAST SH.P.K.**

KRYETARI


Znj. Edlira MUKA



SEKRETARI


Z. Bers Hado